



Pranuar / Dorezuar Prijmljeno/Prodato Received/Delivery	25.07.2023	3	viti god year
Organ./Njesia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKINSHUK	5339/2023		1/1



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.829/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi--anëtarë dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.829/2023 të datës 09.06.2023 të parashtruar nga ankuesit:

e plotësuar me datë 14.06.2023 edhe me ankuesen të cilët me autorizim i përfaqëson Avokat me adresë rruga kundër Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 24.07.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa A.nr.829/2023 e datës 09.06.2023 e plotësuar me datë 14.06.2023 e parashtruar nga ankuesit

II. Mbetet në fuqi Vendimi me Nr. 01/2023 i datës 11.05.2023, Vendimi me Nr. 02/2023 i datës 11.05.2023, Vendimi me Nr. 03/2023 i datës 11.05.2023, Vendimi me Nr. 04/2023 i datës 11.05.2023, Vendimi me Nr. 07/2023 i datës 11.05.2023, Vendimi me Nr. 08/2023 i datës 11.05.2023, Vendimi me Nr.09/2023 i datës 11.05.2023, Vendimi me Nr. 10/2023 i datës 11.05.2023, Vendimi me Nr. 11/20-23 i datës 11.05.2023, Vendimi me Nr. 13/2023 i datës 11.05.2023, Vendimi me Nr. 14/2023 i datës 11.05.2023, Vendimi me Nr. 18/2023 i datës 11.05.2023, Vendimi me Nr. 19/2023 i datës 11.05.2023, Vendimi me Nr.20/2023 i datës 11.05.2023, Vendimi me Nr. 21/2023 i datës 11.05.2023, Vendimi me Nr. 22/2023 i datës 11.05/2023, Vendimi me Nr. 23/2023 i datës 11.05.2023, Vendimi me Nr. 24/2023 i datës 11.05.2023, Vendimi me Nr. 25/2023 i datës 11.05.2023, Vendimi me Nr. 26/2023 i datës 11.05.2023, Vendimi me Nr. 27/2023 i datës 11.05.2023, Vendimi me Nr. 28/2023 i datës 11.05.2023, Vendimi me Nr. 29/2023 i datës 11.05.2023, Vendimi me Nr. 30/2023 i datës 11.05.2023, Vendimi me Nr. 31/2023 i datës 11.05.2023, Vendimi me Nr. 32/2023 i datës 11.05.2023, Vendimi me Nr. 33/2023 i datës 07.06.2023 të Komisionit për Kushtet e Tregut të Punës i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve.

A r s y e t i m

Njësia e Burimeve Njerëzore e Zyrës së Kryeministrit përmes emailit të datës 13.02.2023 i janë drejtuar Drejtorit të Zyrës për Qeverisje të Mirë dhe Drejtorit të Zyrës Ligjore me kërkesë për sqarim nëse neni 7 i Rregullores (MFPT) Nr. 02/2023 për Shtesat për Kushte të Tregut të Punës ka elemente të tejkalimeve ligjore dhe diskriminuese, ndërsa Drejtori i Zyrës për Qeverisje të Mirë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit më datë 15.02.2023 ka njoftuar që në këtë rast kemi trajtim të pafavorshëm dhe të ndryshëm për të punësuar në situata të njëjta.

Drejtori i Zyrës për Qeverisje të Mirë më datë 22.02.2023 përmes emailit i është drejtuar zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve për ndërmarrjen e veprimeve për eliminimin e elementeve diskriminuese.

Njësia e Burimeve Njerëzore e Zyrës së Kryeministrit më datë 16.02.2023 ka dërguar propozimet për shtesat për kushtet e treguat të punës për zyrtarët e Zyrës së Kryeministrit tek Komisioni për Kushtet e Tregut të Punës i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, ndërsa më datë 06.03.2023 Komisioni për Kushtet e Tregut të Punës i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve ka kërkuar nga Njësia e Burimeve Njerëzore e Zyrës së Kryeministrit të rishikohet lista e dërguar dhe të dërgohen listat e ndara me kategori të cilët ju konsideroni se i plotësojnë kriteret për shtesë, kurse më datë 08.03.2023 nga Njësia e Burimeve Njerëzore e Zyrës së Kryeministrit është dërguar lista e propozimeve për shtesa për kushtet e tregut të punës.

Komisioni për Kushtet e Tregut të Punës i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve më datë ka bërë publik Njoftimin për të gjitha institucionet se për shkak të volumit të madhe të kërkesave shtyhet afati për shqyrtimin e kërkesave, ndërsa përmes emailit të datës 13.04.2023 Njësia e Burimeve Njerëzore e Zyrës së Kryeministrit ka kërkuar nga Komisioni për Kushtet e Tregut të Punës i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve vendimin për shtyrje të afatit për vendosje dhe vendimet për shqyrtim të kërkesave individuale, kurse Komisioni për Kushtet e Tregut të Punës i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve më datë 27.04.2023 ka njoftuar Njësinë e Burimeve Njerëzore të Zyrës së Kryeministrit se vendimet do të pranohen brenda afateve pas shqyrtimit të Komisionit.

Njësia e Burimeve Njerëzore e Zyrës së Kryeministrit më datë 12.05.2023 ka kërkuar nga Komisioni për Kushtet e Tregut të Punës i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve që brenda afateve të dërgohet vendimet për shqyrtimin e kërkesave.

Komisioni për Kushtet e Tregut të Punës i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve më datë 11.05.2023 ka nxjerr vendimet: Vendimin me Nr. 01/2023 për ankuesen B.K, Vendimin me Nr. 02/2023 për ankuesen V.H, Vendimin me Nr. 03/2023 për ankuesin P.Sh, Vendimin me Nr. 04/2023 për ankuesin N.T, Vendimin me Nr. 05/2023 për ankuesen F.I, Vendimin me Nr. 07/2023 për ankuesen Sh.K, Vendimin me Nr. 08/2023 për ankuesen B.M, Vendimin me Nr.09/2023 për ankuesen T.D-R, Vendimin me Nr. 10/2023 për ankuesen K.S, Vendimin me Nr. 11/2023 për ankuesen B.M, Vendimin me Nr. 13/2023 për ankuesen Sh.F-G; Vendimi me Nr. 14/2023 për ankuesen S.G, Vendimin me Nr. 18/2023 për ankuesen Q. I-Z, Vendimin me Nr. 19/2023 për ankuesen S.D-K, Vendimin me Nr.20/2023 për ankuesen A.S-H, Vendimin me Nr. 21/2023 për ankuesen B.A, Vendimin me Nr. 22/2023 për ankuesen V.S, Vendimi me Nr. 23/2023 për ankuesen V.F, Vendimin me Nr. 24/2023 për ankuesin M.B, Vendimin me Nr. 25/2023 për ankuesen A.H, Vendimin me Nr. 26/2023 për ankuesen V.S, Vendimin me Nr. 27/2023 për ankuesen A.K, Vendimin me Nr. 28/2023 për ankuesen E.R, Vendimin me Nr. 29/2023 për ankuesin E.A, Vendimin me Nr. 30/2023 për ankuesen I.M, Vendimin me Nr. 31/2023 për ankuesen J.D, Vendimi me Nr. 32/2023 për ankuesen M.L dhe Vendimi me Nr. 33/2023 i datës 07.06.2023 për ankuesen N.X.

Ankuesit të gjithë nëpunës civil sipas akt emërimeve të punësuar në Zyrën e Kryeministrit, më datë 09.06.2023 kanë parashtruar ankesë me numër protokollit 4649/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të plotësuar më datë 14.06.2023 përmes parashtrësës me numër protokollit 829/2023, kundër

vendimeve të Komisionit për Kushtet e Tregut të Punës i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, me datë 16.06.2023 ankesën e ankuesve e ka proceduar për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve. Këshilli, me datë 23.06.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave me rastin e shqyrtimit të ankesës ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 4649/2023 e datës 09.06.2023 dhe Parashtrësën me numër protokollit 829/2023 të datës 14.06.2023 të parashtruar nga ankuesit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimin e datës 07.06.2023 dhe Plotësim Autorizimin i datës 13.06.2023; Kërkesën për sqarim përmes emailit të datës 13.02.2023 nga Personelit ZKM për H.H dhe M.B; Mendimin përmes emailit të datës 22.02.2022 nga Drejtori i Zyrës për Qeverisje të Mirë i ZKM-së për E.S; Përgjigje në kërkesë përmes emailit të datës 15.02.2023 nga Drejtori i Zyrës për Qeverisje të Mirë i ZKM-së për A.K; Emailin e datës 14.02.2023 nga Personeli ZKM për A.L dhe të tjerët; Emailin e datës 14.02.2023 nga A.K për N.X dhe F.S; Emailin e datës 14.02.2023 nga KKTP MFPT; Propozimet për shtesa zyrtar të dërguar përmes emailit të datës 16.02.2023 nga Personeli ZKM për KKTP MFPT; Emailin e datës 06.03.2023 nga KKTP MFPT për Personelit ZKM; Propozime për shtesa për kushtet e tregut përmes emailit të datës 08.03.2023 nga Personelit ZKM për KKTP MFPT; Emailin e datës 06.03.2023 nga I.C për Personelit ZKM dhe të tjerët; Emailin e datës 07.04.2023 nga KKTP MFPT; Emailin e datës 07.04.2023 nga Personeli ZKM për M.B dhe të tjerët; Emailin e datës 13.04.2023, 27.04.2023, 28.04.2023, 12.05.2023 nga Personelit ZKM për KKTP MFPT; Emailin e datës 27.04.2023, 28.04.2023, 12.05.2023 nga KKTP MFPT për Personeli ZKM; Vendimin me Nr. 18 i datës 31.03.2023 i Ministrit të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve; Qarkoren rreth batimit të Rregullores (MFPT) Nr. 02/2023 për Shtesat për Kushte të Tregut të Punës e datës 08.02.2023; Akt Emërimit me Nr. port: 1578-1-2019 i datës 19.08.2019 për ankuesen F.Y; Emailin e datës 15.05.2023 nga Personelit ZKM për ankuesen F.Y; Akt Emërimit me Nr. prot: 09/2013 i datës 02.04.2013 për ankuesen S.G; Emailin e datës 15.05.2023 nga Personelit ZKM për ankuesen S.G; Akt Emërimit me Nr. prot:868 i datës 05.12.2013 për ankuesen S.D-K; Emailin e datës 15.05.2023 nga Personelit ZKM për ankuesen S.D; Akt Emërimit me Nr. prot: 1059 të datës 29.11.2011 për ankuesen T.R; Emailin e datës 15.05.2023 nga Personelit ZKM për ankuesen T.R; Akt Emërimit me Nr. prot: 1058 të datës 29.11.2011 për ankuesen Q.Z; Emailin e datës 15.05.2023 nga Personelit ZKM për ankuesen Q.Z; Akt Emërimit me Nr. prot: 071/2020 të datës 11.02.2020 për ankuesin A.S-H; Emailin e datës 15.05.2023 nga Personelit ZKM për ankuesin A.S-H; Akt Emërimit me Nr. prot: 438/2018 të datës 21.05.2018 për ankuesin E.A; Emailin e datës 15.05.2023 nga Personelit ZKM për ankuesin E.A; Akt Emërimit me Nr. prot: 755/2014 të datës 22.09.2014 për ankuesen V.H; Emailin e datës 15.05.2023 nga Personelit ZKM për ankuesen V.H; Akt Emërimit me Nr. prot: 314/2022 i datës 08.11.2022 për ankuesen E.R; Emailin e datës 15.05.2023 nga Personelit ZKM për

ankuesen E.R; Akt Emërimin me Nr. 121/2019 i datës 13.02.2019 për ankuesen Sh.K; Emailin e datës 15.05.2023 nga Personelit ZKM për ankuesen Sh.K; Akt Emërimin me Nr. port: 228/2017 i datës 30.03.2017 për ankuesin M.B; Emailin e datës 15.05.2023 nga Personelit ZKM për ankuesin M.B; Akt Emërimin me Nr. prot: 1069 të datës 29.11.2011 për ankuesen Sh.G; Emailin e datës 15.05.2023 nga Personelit ZKM për ankuesen Sh.G; Akt Emërimin me Nr. prot: 1002 të datës 29.11.2011 për ankuesen A.K; Emailin e datës 15.05.2023 nga Personelit ZKM për ankuesen A.K; Akt Emërimin me Nr. prot: 149/2014 të datës 25.02.2014 për ankuesen N.X; Emailin e datës 01.06.2023 nga Personelit ZKM për ankuesen N.X; Emailin e datës 18.05.2023, 15.05.2023 nga KKTP MFPT për Personelit ZKM; Emailin e datës 17.05.2023 nga Personeli ZKM për KKTP MFPT; Kontratë për financim të studimeve MASDTER ME Nr. port:07/169 e datës 16.11.2007 e lidhur nga Agjencia për Barazi Gjinore dhe ankuesja N.X; Vendimin me Nr.prot: 07/162 të datës 16.11.2017 të Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencinë për Barazi Gjinore; Shkresë me titull "Avancimi i zyrtarëve nëpërmjet ngritjes akademike" me Nr. prot:07/6357 e datës 25.09.2007; Konkurs për Avancim të Zyrtarëve nëpërmjet ngritjes akademike; Letër shpjeguese me Nr. 167/08 të datës 26.09.2008; Akt Emërimin me Nr. prot:863 e datës 05.12.2013 për ankuesin N.T; Emailin e datës 15.05.2023 nga Personelit ZKM për ankuesin N.T; Akt Emërimin me Nr. prot: 177/2020 i datës 03.07.2020 për ankuesin P.Sh; Emailin e datës 15.05.2023 nga Personelit ZKM për ankuesin P.Sh; Akt Emërimin me Nr. prot: 1032 të datës 29.11.2011 për ankuesen J.D; Emailin e datës 15.05.2023 nga Personelit ZKM për ankuesen J.D; Akt Emërimin me Nr. prot: 398/2022 të datës 29.12.2022 për ankuesen B.A; Emailin e datës 15.05.2023 nga Personelit ZKM për ankuesen B.A; Akt Emërimin me Nr.prot:1053 të datës 29.11.2011 për ankuesen V.F; Emailin e datës 15.05.2023 nga Personelit ZKM për ankuesen V.F; Akt Emërimin me Nr. prot: 1055 të datës 29.11.2011 për ankuesen B.M; Emailin e datës 15.05.2023 nga Personelit ZKM për ankuesen B.M; Akt Emërimin me Nr. prot: 101/2012 të datës 10.02.2012 për ankuesin B.K; Emailin e datës 15.05.2023 nga Personelit ZKM për ankuesin B.K; Akt Emërimin me Nr. prot:133 të datës 16.02.2015 të ankueses A.H; Emailin e datës 15.05.2023 nga Personelit ZKM për ankuesen A.H; Akt Emërimin me Nr. prot: 728/2018 të datës 31.07.2018 të ankueses V.C-S; Emailin e datës 15.05.2023 nga Personelit ZKM për ankuesen V.C-S; Akt Emërimin me Nr. prot:528/2016 të datës 20.07.2016 për ankuesen I.M; Emailin e datës 15.05.2023 nga Personelit ZKM për ankuesen I.M; Akt Emërimin me Nr. prot: 104/2016 të datës 22.02.2016 për ankuesen V.S; Emailin e datës 15.05.2023 nga Personelit ZKM për ankuesen V.S; Akt Emërimin me Nr. prot: 859/2019 të datës 06.08.2019 për ankuesen B.M; Emailin e datës 15.05.2023 nga Personelit ZKM për ankuesen B.M; Akt Emërimin me Nr. prot: 1061 të datës 29.11.2011 për ankuesen K.S; Emailin e datës 15.05.2023 nga Personelit ZKM për ankuesen K.S; Akt Emërimin me Nr. prot:151/2014 të datës 25.02.2014 për ankuesen M.L; Emailin e datës 15.05.2023 nga Personelit ZKM për ankuesen M.L; Akt Emërimin me Nr. prot: 1286-1-2014 të datës 01.07.2014 të ankueses B.B; Emailin e datës 08.06.2023 nga ankuesja B.B për avokat H.S; Akt Emërimin me Nr. prot: 157-1-2014 i datës 03.02.2014 për ankuesen F.S; Akt Emërimin me Nr. prot:1579-1-2019 i datës 19.08.2019 për ankuesin F.M; Akt Emërimin me Nr. prot: 1284-1-2016 i datës 05.09.2016 për ankuesin N.H; Akt Emërimin me Nr. prot:877-01-2014 i datës 06.05.2014 për ankuesin V.B; Akt Emërimin me Nr. prot: 1905-1-2019 të datës 04.11.2019 për ankuesin D.I; Akt

Emërimin me Nr. prot: 221-1-2019 të datës 14.02.2019 për ankuesen L.H; Akt Emërimin me Nr. prot:1287-1-2014 të datës 01.07.2014 për ankuesen B.V; Akt Emërimin me Nr. prot: 874-1-2019 të datës 22.05.2019 të ankueses B.M; Akt Emërimin me Nr. prot: 060-01-2015 të datës 15.01.2015 të ankuese S.K; Akt Emërimin me Nr. prot:1832-1-2019 të datës 17.10.2019 për ankuesin B.T; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 16.06.2023; Përgjigjen në ankesë e datës 23.06.2023; Kërkesë për shmangje nga procedurat e datës 31.01.2023 nga Ministri i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve për Kryeministrin e Republikës së Kosovës; Shkresë me numër Ref: 466/2023 e datës 31.01.2023 nga Kryeministri i Republikës së Kosovës për Ministrin e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve; Njoftim i datës 07.04.2023 nga Komisioni për Kushtet e Tregut të Punës i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve për shtyrjen e afatit të vendosjes për kërkesat e ankuesve; Vendimin me Nr. 01/2023 të datës 11.05.2023; Vendimin me Nr. 02/2023 të datës 11.05.2023; Vendimin me Nr. 03/2023 të datës 11.05.2023; Vendimin me Nr. 04/2023 të datës 11.05.2023; Vendimin me Nr. 07/2023 të datës 11.05.2023; Vendimin me Nr. 08/2023 të datës 11.05.2023; Vendimin me Nr.09/2023 të datës 11.05.2023; Vendimin me Nr. 10/2023 të datës 11.05.2023; Vendimin me Nr. 11/2023 të datës 11.05.2023; Vendimin me Nr. 13/2023 të datës 11.05.2023; Vendimin me Nr. 14/2023 të datës 11.05.2023; Vendimin me Nr. 18/2023 të datës 11.05.2023; Vendimin me Nr. 19/2023 të datës 11.05.2023; Vendimin me Nr.20/2023 të datës 11.05.2023; Vendimin me Nr. 21/2023 të datës 11.05.2023; Vendimin me Nr. 22/2023 të datës 11.05.2023; Vendimin me Nr. 23/2023 të datës 11.05.2023; Vendimin me Nr. 24/2023 të datës 11.05.2023; Vendimin me Nr. 25/2023 të datës 11.05.2023; Vendimin me Nr. 26/2023 të datës 11.05.2023; Vendimin me Nr. 27/2023 të datës 11.05.2023; Vendimin me Nr. 28/2023 të datës 11.05.2023; Vendimin me Nr. 29/20023 të datës 11.05.2023; Vendimin me Nr. 30/2023 të datës 11.05.2023; Vendimin me Nr. 31/2023 të datës 11.05.2023; Vendimin me Nr. 32/2023 të datës 11.05.2023; Vendimin me Nr. 33/2023 të datës 07.06.2023 të Komisionit për Kushtet e Tregut të Punës i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vendosjen e kësaj çështje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka konstatuar se ankesa e ankuesve, është e pabazuar, sepse:

Ankuesit në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendojnë se gjatë këtij procesi ka pasur shkelje ligjore dhe procedurale, ngase me nenin 7 të Rregullores (MFPT) Nr. 02/2023 për Shtesat për Kushte të Tregut të Punës, në kuadër të shtesave janë përfshirë vetëm të punësuarit që kanë kryer studimet e nivelit të dytë të arsimit të lartë në programet studimore të financuar apo të bashke financuara e që është diskriminuese ndaj të punësuarve të tjerë, duke kërkuar që ankesa e ankuesve të aprovohet si e bazuar të shfuqizohet neni 4 paragrafi 4 nën paragrafi 4.3 dhe neni 7 i Rregullores (MFPT) Nr. 02/2023 për Shtesat për Kushte të Tregut të Punës, të anulohen plotësisht vendimet e Komisionit për Kushtet e Tregut të Punës i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve dhe të obligohet Ministria e

Financave, Punës dhe Transfereve që ankuesit t'i njihet e drejta e kompensimit në shtesë për kushtet tregut në mënyrë retroaktive nga data 31.03.2023.

Kuvendi i Republikës së Kosovës, me datë 22.12.2022 ka aprovuar Ligjin Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, i cili me datë 05.01.2023 është publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës Nr.1/5 Janar 2023, dhe si rrjedhojë i njëjti ka hyrë në fuqi me datë 05.02.2023, ku qëllimi i këtij ligji është që të krijojë një sistem të njëtrajtshëm të pagave në sektorin publik që përfshin parimet dhe rregullat për përcaktim të pagës në sektorin publik si dhe të krijojë një sistem të pagave dhe shpërblimeve, transparent dhe të menaxhueshëm ku elementi kryesor është paga bazë, si rrjedhojë sipas nenit 3 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, është përcaktuar se: *"1. Shprehjet, termat dhe shkurtesat e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim: 1.12. shtesë page apo shtesë - nënkupton komponentin e pagës që i shtohet pagës bazë dhe që synon të shpërblejë punën për kushte të vështira, sektorë apo specializime të veçanta dhe që nuk shpërblehet nga paga bazë. Shtesa e pagës mund të jetë e rregullt, kur përfitohet për çdo muaj apo e parregullt kur shpërblehet sipas rastit në bazë të këtij ligji"*, kurse lidhur me sistemin e pagave sipas këtij ligji aplikohen parimet e përcaktuara me nenin 4, respektivisht parimin e barazisë dhe mos-diskriminimit, ku përcakton se: *"1.4. parimi i barazisë dhe mos-diskriminimit - nënkupton që secili, pa kurrfarë diskriminimi, ka të drejtë që për punë të barabartë të marrë pagë të barabartë, duke marrë parasysh natyrën e punës, kërkesat për vendin e punës, institucionin ku ushtrohet detyra si dhe kualifikimin"*.

Përveç përcaktimit të pagës bazë për nëpunësit civil, Ligji Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë ka përcaktuar shtesat dhe kompensimet, respektivisht me nenin 22 janë përcaktuar llojet e shtesave që mund të aplikohen sipas këtij ligji si: *"1. Shtesat që mund përfitohen në bazë të këtij ligji janë: 1.1. shtesa e veçantë për të zgjedhurat/it; 1.2. shtesa për kushte tregu të punës; 1.3. shtesa e performancës; 1.4. shtesa për kushte specifike të punës; 1.5. shtesa për punën pa orar të paracaktuar; 1.6. shtesa për vëllimin e punës; 1.7. shtesa për licencë të avancuar për nëpunësen/in e arsimit para universitar; 1.8. shtesa për nëpunësen/in e sistemit shëndetësor; 1.9. shtesa e performancës për krijuesen/in dhe performuesen/in e artit dhe kulturës; 1.10. shtesa funksionale"*, si rrjedhojë meqenëse në këtë çështje juridike-administrative kemi të bëjmë me *shtesat për kushte tregu të punës*, Kolegji i Këshillit, konstaton se me nenin 24 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, janë përcaktuar se shtesa për kushte të tregut të punës përfitohet për profesione të nevojshme, në pozita të caktuara profesionale deficitare të shërbimit civil dhe shërbimit publik, ku rekrutimi apo mbajtja e nëpunëseve/ve në këto profesione dhe/apo pozita objektivist është e pamundur, ndërsa vlera dhe procedura për përfitimin të këtyre shtesave miratohen me akt nënligjor nga ministria përgjegjëse për financa.

Ndërlidhur me këtë, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, më datë 07.02.2023 ka publikuar Rregulloren (MFPT) Nr. 02/2023 për Shtesat për Kushte të Tregut të Punës përmes të cilës përcaktohen profesionet, kushtet dhe procedurat për përfitimin e shtesës për kushte të tregut të punës, ndërsa profesionet për të cilat mund të përfitohet shtesa për kushte të tregut të punës janë përcaktuar me nenin 4 paragrafi 4 të kësaj rregulloreje, ku përcaktohet se: *"4. Profesionet për të cilat mund të përfitohet shtesa për kushte të tregut të punës*

janë: 4.1.profesionet deficitare në fushën e teknologjisë informative; 4.2. profesionet deficitare në fushën e aviacionit dhe navigimit ajror; 4.3.profesionet nga programet studimore të financuara ose bashkë-financuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës; 4.4.specialistët shëndetësor në profesione deficitare, ashtu siç përcaktohen nga ministria përkatëse për shëndetësi; si dhe 4.5.pozita tjera të caktuara profesionale deficitare të shërbimit civil dhe shërbimit publik, ku rekrutimi apo mbajtja e nëpunësve/ve me pagat e rregullta në këto profesione dhe/apo pozita objektivisht është e pamundur”. Neni 7 i Rregullores (MFPT) Nr. 02/2023 për Shtesat për Kushte të Tregut të Punës, lidhur me shtesat për kushte të tregut të punës për profesionet nga programet studimore të financuara ose bashkë-financuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës ka përcaktuar se për të përfituar këtë shtesë duhet kumulativisht të plotësohen këto kushte: 2.1. programi i studimeve të nivelit të dytë të arsimit të lartë të jetë i financiar ose bashkë-financuar nga Qeveria e Kosovës; 2.2.të kenë të përfunduar studimet e nivelit të dytë të arsimit të lartë në universitete jashtë vendit; 2.3. të kenë vlerësim të performancës mbi notën “mirë”; dhe 2.4.të mos ketë masë disiplinore aktive për shkelje të rënda.

Në kuadër të kësaj rregulloreje, Ministri i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve më datë 31.03.2023 ka nxjerr Vendim me Nr. 18 përmes të cilit është aprovuar rekomandimi i Komisionit për Kushtet e Tregut të Punës për programin studimor të bashkë-financuar nga Bashkimi Evropian dhe Qeveria e Republikës së Kosovës, “Skema e Profesionistëve të Rinj” (Young Cell Scheme-YCS) duke u përcaktuar që shuma e shtesës së tregut të punë për të punësuar në vitin e tretë të obligimit është dyqind euro (200), ndërsa për të punësuar pas vitit të tretë të obligimit, dyqind e pesëdhjetë euro (250).

Ndërlidhur me të gjitha këto, Kolegji i Këshillit, sa i përket pretendimit ankimor të ankuesve që shfuqizohet neni 4 paragrafi 4 nën paragrafi 4.3 dhe neni 7 i Rregullores (MFPT) Nr. 02/2023 për Shtesat për Kushte të Tregut të Punës, ju referua Aktgjykimin në rastin nr. KI10/22 të datës 15.08.2022 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës lidhur me kërkesën e parashtruar nga Sindikata e Institutit të Mjekësisë Ligjore lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimin ARJ.nr.115/2021 të datës 18.11.2021 të Gjykatës Supreme të Kosovës e që ndërlidhet me vlerësimin e ligjshmërisë së Rregullores MD-Nr. 01/2020 për Organizmin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Institutit të Mjekësisë Ligjore.

Kolegji i Këshillit, konstaton se sipas Aktgjykimin në rastin nr. KI10/22 të datës 15.08.2022 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, respektivisht me nenin 75 të tij, thuhet se: “...në këndvështrimin e Gjykatës konstatohet se ekziston një pozicion i qarëe në kuptim të funksioneve të gjyqësorit të rregullt dhe atij kushtetues: i pari kujdeset për ruajtjen e supremacisë juridike të ligjit, përkatësisht përputhshmërisë se akteve nënligjore me ligjin ndërsa i dyti për ruajtjen e supremacisë juridike të kushtetutës, përmes kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjeve dhe akteve nënligjore me Kushtetutën sipas mënyrës se përcaktuar me Kushtetute, në nenin 77 theksohet se: “Në anën tjetër, Gjykata ne baze te nenit 113.7 e ve në funksion juridiksionin e saj rishikues dhe subsidiar për të gjitha kërkesat individuale mbi respektimin e te drejtave kushtetuese, të cilat kanë si objekt kontesti edhe aktet nënligjore normative. Juridiksioni rishikues si i tillë aktivizohet pas shterimit të mjeteve juridike. Sipas këndvështrimit të Gjykatës, kufiri ku fillon dhe ku mbaron juridiksioni i kontrollit gjyqësor ndaj akteve nënligjore normative dhe ku fillon

juridiksioni i Gjykatës Kushtetuese është i mirëpërcaktuar kur bëhet fjalë për ushtrimin e juridiksionit subsidiar (rishikues) të Gjykatës. Në këtë drejtim, pasi që parashtuesit e kërkesës të kenë marre përgjigje përfundimtare nga gjykatat e rregullta, mbi bazën e padisë së tyre mbi kontestin e tyre ndaj ligjshmërisë së aktit nënligjor normativ, atëherë ata legjitimohen që pretendimet për cenimin e të drejtave dhe lirive themelore t'i artikulojnë në ankimin individual kushtetues, me nenin 79 është përcaktuar se: "Rrjedhimisht, Gjykata në vijim e vë theksin edhe tek studimi i Komisionit të Venedikut i cili vlerëson se në lidhje me llojet e normave që mund të paraqiten për vlerësim kushtetues, gjykata kushtetuese duhet të jete e ngarkuar vetëm me verifikimin e kushtetutshmërisë së akteve ligjore, duke ua lënë në parim kontrollin e akteve nënligjore gjykatave të zakonshme, në mënyrë që të shmangin mbingarkimin e 18 saj. (shih studimin nr. 538/2009 [CDL-AD(2010)039rev.] mbi qasjen individuale në gjyqësinë kushtetuese, miratuar nga Komisioni i Venedikut ne sesionin e 85-te (17-18 dhjetor 2010), paragrafi 6)", me nenin 80 është përcaktuar se: "Prandaj, bazuar nga si me sipër, Gjykata konstaton se gjykatat e rregullta të sistemit juridik të Kosovës, duke mos bërë kontrollin e ligjshmërisë së Rregullores së IML-se me nenin 15 të Ligjit për Mjekësinë Ligjore, parashtuesit të kërkesës ia mohuan të drejtën e "qasjes në gjykatë" në kuptim të paragrafit 1 të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-se; dhe për pasojë pamundësuan që rasti i parashtuesve të kërkesës të shqyrtohet në meritat e kërkesës". Si përfundim, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, sipas këtij aktgjykimi, sipas nenit 88 thuhet se: "Gjykata, pas elaborimit dhe shqyrtimit të procedurës së zhvilluar dhe arsytimit të vendimeve të gjykatave të rregullta, konstatoi se: (i) ekziston një pozicion i qartë në kuptim të funksioneve të gjyqësorit të rregullt dhe atij kushtetues: i pari kujdeset për ruajtjen e supremacisë juridike të ligjit, përkatësisht përputhshmërisë së akteve nënligjore me ligjin ndërsa i dyti për ruajtjen e supremacisë juridike të kushtetutës, përmes kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjeve dhe akteve nënligjore me Kushtetutën sipas mënyrës së përcaktuar me Kushtetute; dhe (ii) gjykatat e rregullta të sistemit juridik të Kosovës, duke mos bërë kontrollin e ligjshmërisë së Rregullores së IML-se me nenin 15 të Ligjit për Mjekësinë Ligjore, parashtuesit të kërkesës ia mohuan të drejtën e "qasjes në gjykatë" në kuptim të paragrafit 1 të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-se; dhe për pasojë pamundësuan që rasti i parashtuesve të kërkesës të shqyrtohet në meritat e kërkesës. Ndërsa sipas dispozitivit të këtij aktgjykimi respektivisht sipas pikën III është vendosur: **TË SHPALLË** të pavlefshëm, Aktgjykimin [AR].nr. 115/2021] të 18 nëntorit 2021, të Gjykatës Supreme të Kosovës, Aktvendimin [AA.nr.651/2021] e 6 gushtit 2021, të Gjykatës së Apelit, si dhe Aktvendimin [A.nr. 1430/21] e 5 korrikut 2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe sipas pikën IV. **TË KTHEJË**, për rishqyrtim Aktvendimin [A.nr. 1430/21] e 5 korrikut 2021 të Gjykatës Themelore, në pajtim me Aktgjykimin e kësaj Gjykatë.

Kolegji i Këshillit, nga konstatimet si më lartë, konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është institucion i cili ka për qëllim sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, rrjedhimisht Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është institucion kompetent të bëjë mbikëqyrjen nëse aktet nënligjore janë në pajtueshmëri me ligjet e aplikueshme dhe mënyrën e miratimit të tyre, kështu që ankuesit ndaj këtij pretendimi mund të drejtohen në gjykatat e rregullta.

Duke marr parasysh konstatimet e cekura me lartë, dhe duke marr për bazë që Rregullorja (MFPT) Nr. 02/2023 për Shtesat për Kushte të Tregut të Punës është në fuqi, atëherë edhe vendimet e kontestuara me këtë ankesë si: Vendimi me Nr. 01/2023 i datës 11.05.2023, Vendimi me Nr. 02/2023 i datës 11.05.2023, Vendimi me Nr. 03/2023 i datës 11.05.2023, Vendimi me Nr. 04/2023 i datës 11.05.2023, Vendimi me Nr. 07/2023 i datës 11.05.2023, Vendimi me Nr. 08/2023 i datës 11.05.2023, Vendimi me Nr.09/2023 i datës 11.05.2023, Vendimi me Nr. 10/2023 i datës 11.05.2023, Vendimi me Nr. 11/20-23 i datës 11.05.2023, Vendimi me Nr. 13/2023 i datës 11.05.2023, Vendimi me Nr. 14/2023 i datës 11.05.2023, Vendimi me Nr. 18/2023 i datës 11.05.2023, Vendimi me Nr. 19/2023 i datës 11.05.2023, Vendimi me Nr.20/2023 i datës 11.05.2023, Vendimi me Nr. 21/2023 i datës 11.05.2023, Vendimi me Nr. 22/2023 i datës 11.05/2023, Vendimi me Nr. 23/2023 i datës 11.05.2023, Vendimi me Nr. 24/2023 i datës 11.05.2023, Vendimi me Nr. 25/2023 i datës 11.05.2023, Vendimi me Nr. 26/2023 i datës 11.05.2023, Vendimi me Nr. 27/2023 i datës 11.05.2023, Vendimi me Nr. 28/2023 i datës 11.05.2023, Vendimi me Nr. 29/20023 i datës 11.05.2023, Vendimi me Nr. 30/2023 i datës 11.05.2023, Vendimi me Nr. 31/2023 i datës 11.05.2023, Vendimi me Nr. 32/2023 i datës 11.05.2023, Vendimi me Nr. 33/2023 i datës 07.06.2023 të Komisionit për Kushtet e Tregut të Punës i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, janë nxjerr në kuptim të dispozitave të kësaj rregulloreje, si rrjedhojë Kolegji i Këshillit, konstaton se ankuesit nuk ka ofruar dëshmi të mjaftueshme se të njëjtit plotësojnë kushtet e përcaktuara me nenin 7 paragrafi 2 të Rregullores (MFPT) Nr. 02/2023 për Shtesat për Kushte të Tregut të Punës, kështu që pretendimet e ankuesve për anulimin e këtyre vendimeve janë të pabazuara.

Andaj bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe provave të ofruara nga palët, duke u bazuar në kompetencën e Këshillit dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë -Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.829/2023, datë 24/07/2023

Avdyl BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të ankuesve Avokat
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve;
- Sekretarit të Përgjithshëm të Zyrës së Kryeministrit;
- Arkivit të KPMSHCK-së